ADEM ZAPLLUZHA

LOTI I GOTËS SË DEHUR

Redaktor:
Xhevahir Cirongu

Recensent:
Mazllum Baraliu

Lektor:
Xhevahir Cirongu

ADEM ZAPLLUZHA

LOTI I GOTËS SË DEHUR

Shoqata e Shkrimtarëve
“Fahri Fazliu”
Kastriot, 2014

FJALA E REDAKTORIT

Poet i fjalëve e vargjeve të zjarrta që kanë brenda dashurinë njerëzore.

Të shkruash vargun poetik nuk është e lehtë, për më shumë atëherë kur ke të bësh jo thjesht se një poezi do krijosh, apo do ngelesh aty te ai prag guri që s'do vazhdosh rrugëtimin e shkallëve krijuese më tej.

Me një intuitë krijuese,duke marrë me vete edhe penën e ngjyer me pjalmin e botës shpirtërore, autori i shumë librave me poezi, siç është i mirënjohuri tashmë i letrave shqipe, dhe që ka depërtuar në gjithë kategoritë e masës së lexuesve;që nga lexuesi akademik gjer më i thjeshti. Pra, ai është poeti Adem Zaplluzha. Ai, në radhë të parë plotëson kuadrin e të qenurit njeri, pra sa intelektual, po aq edhe njerëzor, me thjeshtësinë e fjalës e që lexohet shumë thjeshtë, por në vetvete e gjithë gama e botimeve të këtij autori mban gjithësinë gjeografike në shtrirje, dhe atë filozofike në mesazhet që përcjell për te masa e lexuesve.

Po të vështrosh me kujdes këtë ''liqen''krijimesh të autorit Zaplluzha, sidomos të kohëve të fundit; këtu kemi parasysh krijimet dhe botimet e fillim shekullit të XXI bindesh shumë lehtë,sepse shifra e titujve të botimeve të librave me poezi shkon deri tani në 97

vepra letrare. Muza e krijuese e këtij poeti ka një fillim qysh në moshë të re, por pjekuria krijuese e tij zbriti si një meteor qiellor brenda shpirtit në moshën madhore të pleqërisë; së bashku me bukën e thekur të vargut poetik.

Poezia e A. Zaplluzhës hapet si ujëvarë e derdhet në shtratin e Lumëbardhit të Prizrenit, por ndalet me vargun e petaltë të trëndafilave shumëngjyrësh, dhe u jep aromën e zambakut të bardhë kur i lexon nëpër vargun e poezive të këtij poeti aty në vëllimet poetike. Shumëkush që ka lexuar poezitë e poetit kosovar, është befasuar, sepse aty gjen forcën e dashurisë njerëzore, të atdhedashurisë, të lirisë, por edhe tragjiken, dhimbjen, etj.

Poeti di ti këndojë shpirtërisht me vargun poetik,lumit, gurit,zogjve,tragjedive njerëzore, yjeve, hënës e qiellit, pemëve, lotit të nënës, gjer te ëndrrave e të shkuarës e të asaj së ardhmes, pra shpresës për të jetuar të lirë e të lumtur. Edhe në këtë vëllim që është i 98 në serinë e botimeve, autori na paraqet me një tufë buqetë poezish të arrira letrare. Mënyra e stili i të shkruarit, te poeti Adem Zaplluzha, na jep tingullin e ëmbël në vargjet e shkruara dhe të ngrohin qenien shpirtërore përgjatë leximit. Krahasimet, metaforat, e gjithë figurat e tjera letrare, na jepen të qarta e plot kumbim që të frymëzojnë. Vëllimi me titull ’’ Loti i gotës së dehur’’ është me të vërtetë një libër poetik

i arrirë artistikisht letrar që i shtohet bibliotekave tona nga autori A. Zaplluzha.

Te poezia ''Degët e thyera të pemëve'' autori ndërthur qartazi faktet e simbolikat letrare. …Dhe më konkretisht:

……..

''Sot është e hënë?!
Të martën bie shi në qytetin tim''.

Ose:

''Një grua e moshuar i shtinë në rruzare
Ëndrrat e zambakëve të pa çelur,
Edhe në duart e saja
Plot rrudha
I lodhën njerëzit e pemëve''.

Mendimi i poetit nuk rri brenda vetes, por ecën duke kërkuar shtigjet e fshehta edhe te poetët e tjerë. Ai thur vargun e kujtimit për atë, dhe gufon shpirtërisht se miku i tij poet bëri varg poezie që mbetën në memorien e lexuesit tonë si lapidarë me mbishkrimin e fjalës poezi.

Poeti shkruan për poetin! E kush mund të shkruaj më mirë se poeti për poetin!? E pra, veç poetët për poetin kurrkush s'mund të thotë fjalën e dashurisë dhe të pikëllimit përveç se ata, në të gjallë apo në të vdekur!Poeti kosovar Zaplluzha, duket se bashkë

me dashurinë e dhimbjen për poetin Frederik Reshpen, është ulur këmbëkryq mbi pentagramin e vargut. Ai shprehet qartazi se e do poetin edhe kur ai është larguar prej vitesh, por i ringjallur se ka lënë vargjet e pavdekshme të poezisë. A. Zaplluzha e shpreh me këto vargje respektin ndaj kolegut dhe mikut poet, Rreshpeja. Në poezinë ''Miku im i mirë'' shkëputëm këtë strofë ku shkruan:

''Miku im i mirë
Kur je i trishtuar,
Ulu në dhimbjen tënde
Dhe recito vargje nga Reshpja''.

… Por, Adem Zaplluzha, di të presë e të përcjellë edhe vdekjen e dikujt, sa me dhimbje e me trishtim, sepse ajo është pjesë e jetës sonë, një funeral i pa shmangshëm në rrugëtimin e jetës sonë. Vjen një ditë e dashuria hidhërohet kur largohet një i afërm i jonë nga kjo botë. Këtë e shpreh dhe e simbolizon me qarjen e zogjve, me këngën e vajit e të baladave. Dhe më konkretisht, ai shkruan midis të tjerave se:

''Kur qajnë zogjtë
Si nëpër balada këndojnë rapsodët,
Me lahuta të verbëta''.

Po të lundrosh me varkën e mendimit nëpër poezitë e vëllimit më të ri të poetit Adem Zaplluzha ''Loti i gotës së dehur'', do ndjesh aromën e luleve të pranverës në tre kapitujt e librit. Gjerdani i vargjeve

poetike të ngërthen gjithë qenien e shpirtit dhe të japin forcë për ta jetuar jetën. Fjalët e poetit janë prush si zjarri dhe lëshojnë xixa ndriçuese përgjatë leximit të tyre. Poeti sfidon moshën, dhe vargu i poezisë e rinon atë. Kjo një dëshmi e vërtetë dhe filozofike, sepse ai na jep faktin më domethënës krijimtarinë e bollshme dhe cilësore me botimet e tija. Kështu, ky poet i palodhur ka sfiduar çdo hamendje se duhesh me patjetër të jesh i ri në moshë që të shkruash poezinë. E gjithë esenca e poetit Adem Zaplluzha është e ndërtuar mbi këtë fakt që para lexuesit vjen me vëllimin më të ri,(nr. 98 libra).

Në poezinë me titull ‘’Pak është vonë’’ ai shprehet në këtë mënyrë duke dhënë forcën e jetës dhe mposhtjen e vdekjes

‘’Pak është vonë
Ndoshta nesër do nisem
Deri te golgota.
Atje ku çdo njeri vdes çdo ditë,
Për një drejtësi
Të padrejtë’’.

Mesazhet e poetit janë kokëforta deri në rrugëtimin e pafund. Në një tjetër poezi me titull ’’Ku po të lëmë kështu?’’ na kujton moshën e pleqërisë, ndoshta personazhi kryesor mund të jetë edhe vetë autori aty. Atij i dhimbset më shumë se vetja atdheu, sepse vendlindja dhe balta do bëhen vatra

e përjetshme, kurse poezia me vargun e saj do tingëllojnë fuqishëm te brezat që do e lexojnë. Kështu, edhe A. Zaplluzha nuk i trembet vdekjes, e na jep mesazhin e jetës duke u dashuruar pas asaj. Të punosh për atdheun është sublimi më i madh që i ke bërë vetes. Te Adem Zaplluzha e gjen pikërisht te fjala e shkruar shqipe që lë për Atdheun aty në librat e shkruara e sidomos te poezia. E ku ka më bukur se kështu!? …Dhe citojmë vargjet e poezisë:

‘’Po na përcjellin pleqtë
Me pak lot,
e me shumë pikëllim.
Po të lëmë si qyqen
Atdheu im!’’

Poezia të rinon e të jep jetë. Ajo është e pavdekshme. Fjala e poetëve dhe e poetit kosovar A. Zaplluzha, ka fjalën e zjarrtë dhe ngroh shpirtin e njerëzve e në veçanti të lexuesit të poezisë. Në Besianë një lexuese e poezive të autorit, para disa kohësh kur po zbrisnim nga autobusi së bashku me autorin në qendër të qytetit u shpreh kështu: ‘’Po të presin lexuesit, i nderuar poet”

Xhevahir Cirongu!
*Durrës, dhjetor 2013***.**

Si një imazh i largët
Cikli i parë

EJA SONTE

Eja e dashur!
Eja sonte t'i ndezim kandilat e hënës.
Nesër do të të përcjell herët
Pa çelur trëndafilat,
Ti do të jesh me ëndrrën tënde.

Eja sonte, kam nevojë
Aq shumë kam nevojë !..
Për dorën tënde mbi supin tim
Sa që po më zihet fryma.

Mos më lërë në pritje të verbët
Eja të shikojmë,
Se si derdhen vezullimet e yjeve
Nga flokët e thinjur të hënës.

Eja, e dashur eja,
Mos më lërë
Të lutem mos më lërë të pres.
Vetminë tim të dërmuar
Sonte kjo natë
Askujt nuk i përket.

Askujt e dashur...!
Përpos teje dhe trëndafilave,
Që presin të çelin nesër
Mbi pastelet e psalmeve.

Prishtinë, 15 shtator 2013

KUR DËNESIN PEMËT

Ti e dinë e dashur
Se unë për dashurin time ,
Bisedoj me drurët
Zogjve ua ndjej cicërimën në fluturim.

Kur flas me barin
Më dalin para sysh bretkosat e verdha;
Dhe këndojnë
Deri në pambarim psalmet
E pa kënduara.

I thërras shirat që në mëngjes
Kur dita zgjohet,
Nga shpirti i gjetheve shtrydhi
Rrëshirën e rrënjëve ,
Për shërimin e plagëve të lëvores.

Kur dënesin pemët,
Në lagjen tonë qajnë edhe burrat.
Drurët i veshin këmishët e zeza
Dhe ecin trotuareve blu,
Pa krenari
Sa që u përngjajnë endacakëve.

AKOMA NUK KUPTUAM

Kur kam kohë bisedoj me vetveten
Nga drurët huazoj durimin...
Dhe eci nëpër kujtesën e fëmijërisë.
Më kujtohen pilivesat
Këpucët e varura nëpër telat elektrike
Më duken sa qesharake.

Rrugët e kalldrëmta
Po aq edhe serioze,
E di se këndej
Kanë kaluar kuajt e luftës
Tok me kuajt e drunjtë.

Ne nganjëherë u përngjajmë
Jashtëtokësorëve!
Ecim si pemët nëpër mjegull
Dhe asnjëherë,
Nuk ndalemi të burimi.

U mësuam,
Me shekuj ta durojmë etjen
Pranë lumenjve e deteve,
Akoma nuk kuptuam
Se si ankorohen anijet e fundosura.

Bredhim rrugëve të panjohura
Si bufat nëpër tela,
Kur na pyesin për prejardhjen tonë
Fajin ia lëmë historisë.
Megjithatë ,
U përngjajmë të burgosurve kryeneç.

KY GJETH QË BIE NË TOKË

Ndalu, moj përse ikën
Duart e tua i përngjajnë degëve,
Më përqafo si bliri
Ashtu siç i përqafon
Shqisat e të nuhaturit aroma e tij.

Unë jam sot vetvetja ime
Ky gjeth që bie në tokë .
Më duket se ,
Asnjëherë nuk ishte në degë
Ti kaloje rrugës si një hije e veshur
Me fustanin e nusërisë.

Unë nuk desha ta shoh etjen
Në sytë e tua shtrihej shkretëtira.
Ti edhe ashtu hyre
Në një ëndërr të vdekur,
Kur nga shpirti im rebel
Fluturuan zogjtë e ngrirë.

Pranvera po ashtu ishte fishkur
Diku në majat e lisave,
Degët hije rënd
I veshën këmishët e zeza
Mbase dimri ishte të portat e lagjes.

Prishtinë, 16 shtator 2013

AJO ISHTE DIELLI

Ajo është dielli
Dhe hija ime përcjellëse.
Kur nuk jam mirë me vetveten
Nxjerrë nga shpirti i saj,
Një lloj eliksiri
Dhe m'i shëron plagët
Që nuk mund t'i shëroj asnjë mjek.

Ajo është nusja ime
E cila mbi dyzetë e pesë vjet
Nuk e ka hequr,
Duvakun e bardhë të nusërisë.
Me gjasa,
As që mendon ta heq ndonjëherë
Çdo fjalë e saj,
Është bekim sykaltër.

Si një hije ecën nëpër fjalët e mija
Dhe ma freskon shpirtin,
Kur në hidhërimin tim
Si foshnjat e lënë nëpër faltore
Qajnë edhe gjethet.

Ajo është një melhem shërues
Për lazdrimet e mija,
Sa herë që u përngjaj poetëve
Kryengritës.
Me një gotë të ëmbël prej fjalëve
Më zbret në tokë,
Nga kulmi i hidhërimit tim.

KRYQI IM PRTEJ LOTËVE

Kaluan, ose më mirë me thënë
Ikën kohërat e mira!
Po ashtu po ikin edhe vitet
Hijet e tejdukshme,
Kanë filluar të zbresin luadheve.

Bastuni im i ka lëshuar flokët
Në gjysmë shtize,
Vjeshta e trishtuar i hyri në shpirt
Kollitet si lisat pleq,
Në çdo hap po i merren këmbët.

Ikën ditët dhe kohërat
Diku në fund të kësaj ecjeje.
Më pret,
Me padurim më prêt një arkivol
Ka kohë që nuk pushon së qari
Kryqi im prej lotëve.

MË PRIT MOJ VOGËLUSHE

Shoh në buzët e tua të pa puthura
Një ëndërr intime,
Shoh kah galopojnë kuajt e egër
Nëpër mendimet e tua prej
Një adoleshenteje.
Galopojnë dëshirat
E nuk ndalen në asnjë liman.

Ti ecën rrugëve të kalldrëmta
Si një sutë e pazbutur,
Flokët e tua të gështenjta
U bëjnë hije,
Zogjve të mendimeve.
Ti kalon lehtë buzë Lumëbardhit
Si një mbretëreshë,
Që kurrë nuk mendoi për abdikim.

Më prit moj vogëlushe e egër
Më prit kur të rritesh,
Si një shelgje shortuar që pret
Shiun e vonshëm të pranverës.

Më prit!
Unë do të jem te Ura e Gurit.
Aty ku për herë të parë ,
U takova me buzëqeshjen e erës.

PIKONTE TRISHTIMI

Unë fare mirë di se sa të kujtohen
Shelgjet e pikëlluara,
Vetëm atë çast qeshën...
Kur ti i krehe në shuplakat e tua
Flokët e verdha të mjegullave.

Zogjtë putheshin si dy njerëz
Mbase imitonin puthjet tona.
Era e fortë e vjeshtës,
Nuk kishte tjetër alternativë
Përpos të këndonte te një zgërbonjë.

Në vend se të ishe e lumtur
Nga shpirti yt si rrëshira e mykur
Pikonte trishtimi?!.
Ti i lë flokët te rrapi
Dhe u zhduke me erën.

Më pastaj se çfarë ngjau
E mësuan vetëm kalldrëmet Ilire,
Kur qante zemra jote , mendjelehtë
Takat e tua të thyera,
Filluan të trokasin në çdo portë.

SHKO KU TË DUASH

Po t'i lë të hapura të gjitha udhët
Nëse do,
Shko ku të duash.
Unë më nuk kam kohë
As mundësi me të pritë.

Këtu çdo ditë bien shirat
Është stina e lotëve,
Ditët janë tepër të gjata
Kur njeriu vuan.

Nëse shkon sonte,
Kthimi do të jetë i pamundshëm.
Të lutem!
Mendo dy herë
Para se ta qesësh hapin e parë.

Po t'i lë të hapura të gjitha udhët...
Shko ku të duash!
Largohu nga kjo letargji e dashurisë,
Por nëse ikën
Sonte mbyllen të gjitha udhët.

JAM PO AI NJERI

Ka kohë që ndjej lodhje
Eshtrat kërcasin si flakët e pishës,
Lëbyrjet e syve
M'i rëndojnë qepallat.

Kurse ti akoma paske mbetur
Po ajo nuse e re,
Nën duvakun e vajzërisë
Sot po i fsheh të gjitha trishtimet
E një unaze të heshtur

Shiko se si kam mbetur
Si një zog krahë thyer,
Jam po ai njeri
I ngarkuar me dhembje.

Ti atë natë ike diku larg
I përngjaje zogjve shtegtarë,
Dole nga shpirti yt kallkan
Dhe si mashtrimi hyre
Në botën e gënjeshtrave .

Kaluan qindra vite qensh të zgjebosura,
Dhe po aq trishtime rrodhën
Nën brigjet lapërdhare
Të Lumëbardhit.

Ndoshta ishte dita dhe koha e gabuar
Ose vet jeta e jonë,
Ishte një gabim
I papërmirësueshëm.

SOT MË NUK JAM UNË

Kjo stinë e luleve
Rri ulur mbi një rrasë guri,
Rri dhe si qyqja vajton
Lindjen e kallkanëve në ulluqet e çative.

Më duket se në çdo hap
Si bari,
Po mbinë kristalet prej akujve.
Çdo fjalë e jote dhemb,
Si kallkan prej zjarri ma djeg trurin.

Hesht !
Mos fol asgjë sonte.
Lëre dhembjen time të shkrihet
Si ajo copë akulli
Në zjarrin përvëlues të jetës.

Sot më nuk jam unë
Por një qenie,
Pa peshën e saj specifike
Që bredh rrugëve të ferrit
Deri në asgjësim.

DEGËT E THYERA TË PEMËVE

Sot është e hënë,
Të martën bie shi në qytetin tim.
Kallinjtë tunden si të ishin të dehura
Mes zambakëve të bardhë ...
Ti si fantazmë i kërkon
Ëndrrat e tua të sfilitura.

E di të mërkurave
Sërish ka filluar,
Të bie shi në flokët e erës.
Po ai shi,
Që binte para dyzetë vjetëve,
I përzier me lot nusesh
Kur vajtonin
Si zogjtë e trishtuar te lama e drithit.

Ditët këtu nuk kanë emra
Ose kanë mbetur të zbrazëta
Si shpirtrat e hijeve..!

Një grua e moshuar i shtinë në rruzare
Ëndrrat e zambakëve të paçelur,
Dhe me duart e saja
Plotë rrudha,
I ledhaton njomësit e pemëve.

Ditët këtu vdesin për një emër
Buzë trotuareve...
Dalin vashat dhe i ndajnë
Buzëqeshjet me kalimtarët e rastit.

Era si e trentë frynë fustanet e shqyera
Degët e thyera të pemëve ,
Lakohen deri në tokë
Nga pesha e ngrirë e kallkanëve.

KALON DETE E MALE

Dashuria i përngjan zogut rebel
Fluturon edhe me krah të thyer,
Prej një çatie në tjetrën .

Kalon dete e male,
Kur fundoset si anijet e pa ankoruara
Asnjëherë nuk i lëshon dizgjinët e erës.

Mes tërbimit të dallgëve
I kafshon hënëzat e verdha,
Dhe i përngjan varkave të humbura.

Kur vjen mbrëmja hynë në ëndrrën e gjumit
I përngjan baladave të vjetra,
Për të nesërmen asnjëherë nuk mendon.

Prishtinë, 17 shtator 2013

NËPËR KËTO RRUGË TË PASOSURA

Kur hingëllimat e kuajve bashkohen
Me përgjumjet e hijeve,
Një dele e egër blegëron në sukë
Paska ardhur pranvera.

Ti akoma endesh rrugëve
Hulumton prejardhjen e gjetheve,
Dhe shpirtin e dikurshëm
Të një udhe të vjetër,
Që i zgjon nga letargjia
Arabaxhinjtë e kotur.

Ndoshta në këtë përgjumje të ngurtë
Hingëllon edhe nata hileqare,
Nëpër këto rrugë të pasosura
Kaluan edhe ujqërit,
Ashtu siç kalëronin kalorësit e zinj.

Ah, ajo udhë e gjatë!
E një kohe të egër dhe të paharruar...
Mbi kalldrëmet e lëmuara ilire
Fshihte një tradhti të lëngtë,
Zgjatej si gjarpri i zi.
...E nuk kishte askund të sosur
Sa që i përngjante pabesisë.

IA FALËN EDHE DASHURINË

Perëndit e mi të ngratë
Nuk mund të hynë në hinore,
Më shumë se njëmijë vjet
Enden rrugës Via Ignatia.
Dhe si eremitët e humbur
Dehen me lot gjethesh të njoma.

Pandërprerë bredhin si hijet
Nëpër sinorët e atdheut,
Mbjellin nga një lastar dafine
Dhe prej rrënjëve të rrapeve.
Shtrydhin një lloj eliksiri
Për shërimin e plagëve të nuseve.

Perëndit e mi të mermertë
Në çdo kohë,
Shndërrohen në statuja të lëngëta
Mes kolonadave prej gjaku.
U bëjnë hije luftëtarëve të atdheut
U bëjnë hije atyre,
Që kësaj toke të bekuar
Ia falën edhe dashurinë.

TË MBIJË E NESËRMJA

Në këtë çast hyjnor,
Dua që lirikat e mija të enden
Prej një cepi,
Në cepin tjetër të atdheut.

Të bisedojnë me njerëzit
E zakonshëm,
Për dhembjen e përditshmërisë.

Dua që çdo varg i imi
Të burojë nga thellësitë,
Si uji i kristaltë i Sharrit kryeneç
Për t'i ujitur dhe mbajtur në jetë.
Shpirtrat e lisave
Që me shekuj qëndruan vertikalisht.

Të rendin si eremitët
Nëpër shpirtrat e njerëzve,
Duke mbjellë nga një copë shprese.

Mbi çdo shkëmb të stralltë
Të mbijë e nesërmja,
Me modestinë
E bukurin e lirikave të mija.

CILI PLEP

Koha është që sonte
T'u përngjajmë njerëzve,
Duhet të jemi të vetëdijshëm
E dashur!

Të mos grindemi si fëmijët
Për çdo imtësi banale,
Të mos i thyejmë gotat
Për kokën e njëri - tjetrit.

Kjo natë nuk duhet t'i përngjan
Netëve të tjera!..
E cila në shpirtin e saj
Ruan një kujtesë të paharruar.

Të cilën e di ti më mirë se unë,
E dimë kohën kur e mbollëm plepin.
I mbajmë në mendje çastet
Kur i kishim sytë e kaltër.

Me siguri të kujtohet
Kur një vjet më vonë,
Në të njëjtën natë dhe kohë
E mbollëm edhe plepin e dytë.

Edhe pas dyzetë e pesë viteve
Nuk mësuam asnjëherë,
Se cili plep
I lëshoi më thellë rrënjët
Në shpirtra tona të sfilitura.

PADUKSHMËRIA

Jam bërë i padukshëm!
Nuk më njohin as fushat e plagosura.
Ky luadh,
Ku është fishkur bari
I ka humbur të gjitha shpresat.

Edhe ky lis paska mbetur
Si një kërcu i vetmuar,
Nga rrënjët e tij pikon helmi.
Si fjalët,
Që vrasin fluturimet e zogjve
Kur shtegtojnë,
Në atdheun e tyre të kafshuar.

Kjo padukshmëri
Mbase mbi njëqind vjet,
Banon te njerëzit
Dhe asnjëherë
Nuk u përngjan njerëzve.

Çdo gjë në këtë imazh duket
Si plumbi i padukshëm,
I zarfeve të verdha
Që shtegtojnë nëpër kontinente.

Jam shndërruar në një pjesë të sëmurë
Që s’shërohet,
Me asnjë melhem.
Kjo dhembje koke gati një shekull
Po troket,
Në portat e mbyllura të atdheut.

SI NJË IMAZH I LARGËT

Të kam thënë e dashur
Se puthja e jonë ka mbetur,
Si një imazh i largët.
Jemi lodhur,
Çdo gjë sot i përngjan
Vetëm si një mirazhi në kujtesë.

Ishte mirë tepër mirë
Në ato kohërat e mira,
Edhe ne ishim si dy pëllumba
Të egër në degët e një peme.

Herë grindeshim
E herë i gjuanim çarçafët,
Përtej dritareve
Kur banonim në katin e parë.

Njëherë patëm qesh deri në mëngjes
Me zgjuarsinë tonë në thonjëza.
Qeshëm !
Ngase nuk ishim në gjendje,
T'i numëronim puthjet tona .
Dhe mbetëm,
Siç the ti atë natë
Injorant të lindur në matematikë.

KAM NEVOJË

Sonte më duhen duart e tua
Kam nevojë,
Sa shumë kam nevojë ..!
Për një buzëqeshje
Kjo kohë po brenë shpirtin.
Vetmia si qeni i egër
Më kafshon në zemër.

Mos shko askund
Nëpër të cilët udhë i lë,
Zërat e gjetheve
Që aq bukur dukeshin
Nën flokët e jastëkut të djersitur.

Po më kumbojnë në shpirt
Hapat e tua,
Si daullet e trishtimit
Po dëgjohen,
Të rrahurat e zemrës së thyer.

Sonte kam nevojë vetëm për ty
Mungesa e jote,
Po ma zë frymëmarrjen.

Më kupto e dashura grua
Unë kam nevojë për ty,
Sa shumë kam nevojë
Për aromën
E lëkurës tënde me aromë bari.

VETËM NJË QYQE MALI

Ik dhembja e ime
Largohu sonte,
Mua më mjafton kjo qetësi
Dhe hëna që lundron.
Si një varkë e thyer
Në qiellin e mrrolur të kujtesës.

Askush nuk këndon
Askush edhe nuk qanë,
Mbase kanë vdekur
Sonte serenatat!?

Vetëm një qyqe mali
Përmallshëm është duke dënesur,
Nën vetullat shkulura
Të meteorëve.

Çfarë po ngjan sonte me ikjet?!
Fluturuan atje prapa diellit
Edhe lejlekët e fundit,
Vetëm dhembja e ime
Troket,
Ç'mendurisht po troket
Nëpër dyert e hapura të Lumëbardhit.

NJË DITË DO TË KTHEHEM

Pas shpine s'dëgjohet asnjë fjalë
Vetëm era memece,
Frynë e fryn ngadalë
Një mal me gjethe veshur
Parakalon si kardinal.

Nëpër shitoret e kinkalerive
Mund të blejmë,
Arkivole të bardha dhe të zeza
Te kajsishtat e lagjes
Shkunden ditët si kujtimet.

Të lutem, më prit edhe mua
Një ditë do të kthehem,
Me tërë peshën e viteve
Do të kthehem,
Ngarkuar me fatin e trishtimit!

Të lutem!
Mos më merrni për të keq,
Ky jam unë i tëri me gëzimin
Dhe hidhërimin tim,
Më pranoni ashtu si isha dhe jam sot.

Kur e përkundnim mbrëmjen
Cikli i dytë

NJERËZIT DHE RRUGËT

Mbrëmë më ra në sy
Se si flasin rrugët,
Flasin, por askush nuk i kupton.
Frymëmarrja e tyre
U përngjan atyre të gjetheve
Nganjëherë qeshin si drurët.

Më duket se kanë një gjuhë të përsosur
Vetëm era kupton alegorinë e fjalëve.
Dhe lisat,
Që i përcjellin me një sy ecjet e njerëzve
Kur qeshin rrugët,
Qeshin edhe vitrinat.

Mbase qepenat e vjetër luajnë
Si në ndonjë teatër antik,
Një lloj pantomime
Që nga kohërat homerike.

Njerëzit dhe rrugët,
Më së miri kuptohen njëri me tjetrin.
Ua dinë hallet,
Dhe qajnë si një kërthi
Kur qajnë edhe lisat buzë rrugëve
Të rrënuara prej shirave.

Çuditërisht mbrëmë kuptova
Se gjuha e një vaji të rrugës,
Sa shumë i përngjan gjuhës së njeriut
Që i këndon psalmet e një kohe,
Kur qanin dhe qeshnin rrugët
Si njerëzit parahistorik.

PO TË KISHA MUNDUR

Po të kisha mundur
Do i zbritja yjet një nga një,
Mbi flokët e tua kaçurrela
Në gjumin tënd do i sjellja
Të gjitha ëndrrat e fëmijërisë.

Po të kisha mundur
Me shekuj,
Nuk i kisha ndalur fjalët
E gjetheve kah bien në prehrin tënd.

Do isha njeriu më i lumtur
Me atë pantomimë pa fjalë ,
Pa zë dhe me një lëvizje
Po aq banale.

Po të kisha pasur mundësi
Të shndërrohem në hije të padukshme;
Do ta përcjellë deri në amshim
Ty dhe siluetën tënde të mëndafshtë.

Po të kisha mundur!..

BINI DAULLEXHI

Po bien e s'pushojnë daullet
Bini!
E mos u ndalni
Bini mbi lëkurën time
O daullexhi.
Bini deri në asgjësim të ekzistencës.

Si zërat e shirave
Ushtojnë sonte tupanët,
Ushtojnë
E nuk ndalen shushurimat
E gjetheve të njoma.

Bini e mos e ndalni këtë lojë
O daullexhi!

Dëgjoni diku pas atyre maleve
Janë zgjuar jehonat,
Si rrënjët
Shushurijnë shpirtrat pagan.

Në gëzimin e pagurit
Zgjohen edhe nuset,
Sonte po vallëzojnë lisat
O daullexhi.

Kujdes!
Po zbresin nga malet
Zërat heroike të një kohe.
Po zbresin,
Shpirtrat e gjyshërve .

Po zhaurinë
Si ujëvarat e legjendave,
Dasmat s'paskan të ndalur
Bini daullexhi!
Bini daulleve të kushtrimit.

Prishtinë, 18 shtator 2013

SECILI PREJ NESH

Secili prej nesh
Një ditë do të udhëtojmë me shirat.
Pas dendësisë së mjegullave
Fshihen zogjtë e fatit.

Secili prej nesh kur u këndellëm
Vetëdija vraponte si kaprolli i frikësuar.
Imazheve të ngrysura
Para nesh,
Si shkretëtira shtrihej e panjohura.

Të tjerët thoshin nënë buzë:
Pastë fat !
Ky njeri i vogël
Çfarë urate nga njerëz të pafat
Kur u rritëm veç ishte natë.

Këndonim ndonjë psalm
Fjalët i përngjanin gurëve të kuq,
Që e rrokullisnin
Fëmijët e Sizifit,
Që nga fëmijëria duke bartë
Atë pjesë dheu të padukshëm të jetës.

NJË ZOG

Thonë se ju kanë parë
Duke ecur këmbëzbathur,
Mbi njelmësinë e lotit
Te një deti.
Peshqit vinin pas jush
Po ashtu kuajt edhe luanët.

Një njeri pagan si një lis
Qante mbi një dunë prej rëre,
Qante për ikjen e stinës
Sa më shumë dëgjohej vaji i pikëllimit.
Aq me tepër,
Zhdukej zëri i shkretëtirës.

Një njeri si një madhështi
Me një kalë të bardhë ,
Kalëronte mbi re.
Kurse njeriu tjetër pagan
Me të dy këmbët mbeti vetëm në histori.

Thonë se po çfarë nuk flasin?!
Për anijet fluturuese,
Dhe ato planetare...!
Një zog akoma noton
Nëpër qepallat e njelmëta
Të Detit Jon.

NË NJË RRUGË ASNJANËSE

Në gjeografin e shpirtit hynë
Dhe dalin qindra lloje meteorësh.
Mbyten detet,
Shtrëngatat e ujit qohen peshë
Në kiçet e anijeve të fundosura
Vallëzojnë hënëzat e verdha.

Ky njeri i mirë që është duke
Shkel mbi trishtimin tim,
Mbase është dërguar nga yjet
Dora dhe shpirti i tij kallkan.
Bisedojnë me rruazat e kuqe të gjakut
E gjaku i ngrirë,
Po heshtë si përmendore.

Kah janë nisur njerëzit
Në këtë kohë të pakohë,
Bredhin si yjet
E humbur në shpirtin e galaktikës.

Shoh që kanë mbetur të vetmuar
Në një rrugë asnjanëse,
Rendin si somnambul
Pranë hijeve të dyshimta.
Rendin nëpër një udhë
Kah kalojnë kuajt e drunjtë!?

DO PRESIM EDHE NJË KOHË

Kur vjen dimri ai i ziu
Në mua si shëmtimi sokëllin era.
Kuajt e ujit,
Ikin tejpërtejmes
Ikin për të mos u kthyer asnjëherë.

Kallkanët si bastunët e pleqve
Qëndrojnë varur nëpër ullukët e çative
Gjysmë të rrënuara,
Një erë e ftohtë
Frynë në katin e tretë të mendjes.

Jashtë hapësirës ku lindin alienët
Kanë dalë njerëzit te mjegullat,
Dhe i përshëndesin lejlekët
Ka kohë që në tokën tonë
Nuk i pamë,
Lotët e gëzimit të të reshurave.

Do presim edhe një kohë
Sa të zgjohen nga gjumi letargjik
Banorët kryengritës,
Të këtyre maleve
Do të presim për herë të parë
Ndryshimin e stinëve.

TROKIT SI I ÇMENDUR

Kur s'kam se çfarë të bëjë
Trokas,
Çmendurisht trokas në portat
E mbyllura të vetëdijes.

E mbyllura përherë
Është e mbyllur,
Dhe asnjëherë nuk hapet.
Çfarë të bëjë me duart e mija
Që rrinë varur,
Si degët e akacies në kujtesë.

Trokas edhe në kotësinë time
Sa të do shpirti trokit o njeri!
Më thotë një zë:
Nga brendia e lisit
Trokit edhe atje ,
Ku nuk hapen portat.

Nëse do mund të trokasësh askund
Ti trokit në shpirtin e gurit,
Trokit miku im !
Trokit si i çmendur
Vetëm guri i kupton trokitjet e tua.

Prishtinë, 19 shtator 2013

SA E GJATË KJO NATË

Nuk mund të kuptoj
Pse sonte metaforat e shpirtrave,
Kërkojnë artin e shprehjes.
Fshehtësinë e një loje tinëzare
Nëpër xhepat e shqyera
Të pantomimës.

Mbrëmë nuk kishte njeri
Që mund t'i ndalte shirat!
Të mos bien,
Mbi flokët e thinjura të stinës.
E kjo stinë e lagur
Mbase sivjet po dimëron,
Si arinjtë e egër nëpër shpella polare.

Ikin nëpër vende të panjohura
S'po na kthehen më ,
Miqtë e dikurshëm të fëmijërisë
Nuk po kthehen këndej pari,
Si lejlekët në pranverë.

Asnjëri nuk u përngjan zogjve shtegtarë
Po largohen fshehurazi;
Me nga një arkivole në shpinë
Duke i kërkuar nëpër ëndrrat e shthurura
Kryqin e një fati të hidhur.

I kemi humbur të gjitha rrugët
Si mund t'i përngjajmë njeriut
Që ecën vertikalisht.
Deri te një dritë vezulluese
Pas së cilës,
Fshihen yjet endacak të shpirtrave.

Sa e gjatë kjo natë kur më ikën gjumi..!?

MIKU IM I MIRË

Miku im i mirë
Kur je i trishtuar,
Ulu në dhembjen tënde
Dhe recito vargje nga Rreshpja.

Mos u ndal
Në asnjë dunë të erës,
Shko deri atje
Ku të pret Frederiku i madh.

Miku im i mirë
Kur je i pikëlluar,
Më prit edhe mua
Të qajmë në duet.

Ta vajtojmë fëmijërinë
E humbur,
Që s'mund ta gjejmë
Në asnjë emër të përshtatshëm.

Shikoi këpucët tona të shqyera
Sa shumë po i përngjajnë,
Tullumbave të Lulit.

PAM NJË AKT TË NGRIRË

Era i picërronte sytë,
Dhe i shtrëngonte grushtet.
Jashtë acari,
I lëpinte buzët e kallkanëve.

Një mermer i ngrirë,
fshihej mes kolonadave të ngricës.
Në shpirtin e çatisë,
Bora e kuqe hyri si trishtimi.

Brenda një shtëpie të rrënuar
Një oxhak i vetmuar,
Pa asnjë copë dru
Bisedonte me hirin e një viti të harruar.

Shtiza të helmuara nga tavani i vjetër
Mbushur me merimanga,
Zbritnin kohortat e kallkanëve
Kur u lëshuan perdet antike
Pamë një akt të ngrirë.

MËNGJESI GDHIU

Hëna si një lehonë
E bekuar,
Rrinte diku pas bjeshke.
Ylberet pritnin me padurim
Një lindje të madhe.

Në sofrën e galaktikës
Ishin ulur yjet,
Dhe pritnin të filloj dasma.
Meteorët i kishin mbushur pagurët
Me kulloshtër,
Dhe zbritnin te sheshi i madh.

Një tjetër hënë
Hyri në shpirtin e orbitës,
Kambanat s'pushuan atë natë.
Mëngjesi gdhiu
Më herët se kurdoherë.

ZARFI I KALTËR

Me një letër të kaltër
Në sqepin e kuq,
Lejleku i verdhë rrinte mbi një oxhak.
Ku askush më
Nuk banon në atë shtëpi
Ka kohë që janë mbyllur portat.

Si një betejë e panjohur
Shtrihej e panjohura
Në mendimet e shpendit shtegtarë;
Askush nuk po i hap dyert
Paska mbetur pa njerëz kjo shtëpi.

Letra mbi çati zhaurin
Si një gjethe e fishkur vjeshte
Lejleku dënes,
Si nusja që e pret dhëndrin
S'paska mbetur njeri i gjallë këtu
Kujt të ja dorëzoj zarfin.

Qanë edhe çatia pa lot
Nga të dy anët qenkan mbyllur dyert.
As lejleku më,
S'di se çfarë të bëjë
Kujt të ja dorëzoj në dorë
Zarfin e kaltër të një mërgimtari.

ERA E FTOHTË

Më është shndërruar trupi
Në një lisi të rrëzuar,
Nëpër zgërbonjat e të cilit
Kalojnë si ethet,
Ciklone të tërbuara dallgësh.

I vetmi mik besnik
Që më ka mbetur
Është stoli im i molisur.
Te parku i vjetër,
Dhe gjethja e një stine të harruar.

Kush po troket sonte
Si korbi,
Në xhamat e kujtesës!

Paguri i vjetër mbi tavolinë
Si një pikturë surrealiste,
Mbushur me verë të bardhë
Me padurim pret,
Ndonjë mysafirin të paftuar.

Sonte askush më nuk e hap derën
Ta pimë për shëndetin e erës,
Gllënjkën e fundit të trishtimit .

Në kopshtin e kajsishtave
Kalben kajsitë,
Të vjelat e pjergullave
Po thahen nëpër degë.

Era e ftohtë
Akoma sivjet po frynë,
Nëpër zgërbonjat
E shpirtit të vetmuar të rrapit.

PRESIN VDEKJEN E DIKUJT

Sa herë që i lash fjalët peng
Në shpirtrat e kortezheve,
Zgjohej një trishtimi i egër
Sa që të kafshonte në shpirt.

Vrapova si i trentë
Nëpër zhaurimën e një dallge,
Mbeta në fillim të rrugës
Anijet veç,
Kishin përfunduar me ankorimin.

Ecja ime nuk i përngjante askujt
Më merreshin këmbët,
Kurse bastuni im i vjetër.
Për të dhjetën herë
Rrëzohet dy hapa para meje.

Këtu njerëzit s'ta zgjasin dorën
Presin vdekjen e dikujt,
Që të nesërmen
Të thurin oda e ditirambe.

Kur qajnë zogjtë,
Si nëpër balada këndojnë rapsodët
Me lahuta të verbëta.

SHKUNDE TRISHTIMIN

Kur je i uritur ulu mbi forcën tënde
Dhe imitoje të kaluarën,
Ngjitu maje peme
Shkunde trishtimin e urisë .

O njeri i mirë shkunde trishtimin
Se përndryshe fundi është afër,
Sa që ti asnjëherë
Nuk mund të transformohesh në perëndi.

Prej forcës së skamjes
Dikur janë ndërtuar,
Piramidat mbi shpirtin e rërës
Edhe malet u ngritën në këmbë.

Gurtë rrokullisen tërmal
Mendjes së njeriut;
Detet shndërrohen në duna
Të lëngëta prej rëre.

Uria i ka sytë aq të trishtuara
Sa që mund ta verbojë edhe diellin,
Kur u këndon psalme të lashta
Meteorëve endacak.

SA HERË QË E HAPIM GOJËN

Për çdo ditë dhe në çdo kohë
Në teatrin e rrejshëm të jetës,
Jemi artist të përsosur
Me gënjeshtrat tona mund ta mbërrimë
Zenitin e befasisë së shtatë.

Sa herë që e hapim gojën
Nevojë e pa nevojë,
Zbresim teposhtë shkallëve
Të normave njerëzore.

Me rolet tona qesharake
U përngjajmë klounëve endacak,
Dhe sërish si njerëz që jemi
Nuk kemi forcë,
Të ja vëmë dizgjinët vetes.

U përngjajmë kuajve
Kur largohemi nga mëgojëzat!..
Një yll i shëmtuar,
Mbi kokën tonë ngrit folenë e së keqes.
Kurse ne kapemi për atë yll
Si i mbyturi,
Për fijen e kashtës së mykur.

MIQTË E MI TË VJETËR

Zbrita nga kontrapunkti i fjalëve
Vrapova si somnambul i dehur;
Rrugëve të fëmijërisë
Asnjë kalimtarë i njohur.
Ose i panjohur
Nuk pinte ujë shatërvani.

Çarshia e dikurshme
Nëpër gjumin e së cilës,
Si të shastisur vraponin
Djelmoshat e mëhallës
vuante nga etja.

Buzë lumit vraponin
Pas hijes së një vashe sykaltër,
Tani i tërë peizazhi kishte mbetur
Pa dyqanet e saja të vjetra.

Më duket se kisha ortodokse
Ishte zvogëluar pa masë,
Asnjë njeri nuk hynte e as që delte
Nga shpirtngushtësia e saj
Si dikur kur vraponin te popi i tyre
Për t'i bekuar armët.

Njerëzit dukeshin krejtësisht ndryshe
Po ashtu edhe miqtë e mi të vjetër;
E të moshuar,
Duke i lexuar gazetat e vjetra
Veç ishin shndërruar në harresë.

PAK ËSHTË VONË

Në orët e vona
Kur dëgjohen kambanat
E heshtjeve,
Në shpirtin e një kontrapunkti
Lehin meteorët.
Tmerrësisht lehin
E nuk pushojnë mjegullat.

Pak është vonë
Ndoshta nesër do të nisemi,
Deri te golgota.
Atje ku një njeri vdes çdo ditë
Për një drejtësi
Të padrejtë.

Pastaj do presim në ankth
Një rigjykim të dytë,
Shi do të bie
Në anën e kundërt të mendjes.

Po që se largohen zogjtë
Do të fillojnë të shkrihen
Kallkanët e mendimeve.

Ky lloj teatri endacak
Sonte i paska harruara ,
Të gjitha rolet
Kur të mbërrimë në fund të rrugës
Do kuptojmë ,
Se si qajnë zogjtë e Parajsës.

THUA SE JANË TË DRUNJTA

Sa shumë qenkam plakur sivjet
Diçka po ma sëmbon,
Lëkurën e regjur pas shpine.
Këpucët po lëvizin më ngadalë
Aq ngadalë,
Thua se janë të drunjta.

Nuk vijnë më as mjegullat
Në qytetin tim,
Ose më janë errësuar sytë
Dhe s'jam duke parë asgjë,
Kush po zbret teposhtë asaj rruge
Me mallin djaloshar.

Po thonë se
Në lagjen e poshtme,
Sërish po dëgjohen kambanat..!
E çfarë më duhen mua tani?!
Ka një kohë të gjatë
Që më kanë tradhtuar
Shqisat e të dëgjuarit.

Prishtinë, 20 shtator 2013

KU PO TË LËMË KËSHTU

Duke ikur varg e vi
Si kopetë e egra,
Shtigjeve të pakalueshme
Po dalim tej kufirit shqim.
Po të lëmë si qyqen
Atdheu im.

Po na përcjellin pleqtë
Me pak lot,
E me më shumë pikëllim
Po të lëmë si qyqen
Atdheu im.

Po të lëmë me dertet
Dhe hallet e tua,
Kryesore ne të shpëtojmë
Por nuk dimë,
Se kah po na qojnë udhët
Atdheu im.

Në erë e terr,
Po zhdukemi si zogjtë e qyqes
Po të harrojmë ,
Duke të lënë në ferr
Atdheu im.

Po të lëmë me gjëmën tënde
Ne po ikim,
Si zogjtë e verbër shqim.
Ku po të lëmë kështu
Atdheu im?!

KUR E PËRKUNDNIM MBRËMJEN

Kur të zë trishtimi
Mua do të më kesh pranë;
I tëri kështu siç jam
Do vij të qajë në prehrin tënd.

Të kujtohet,
Kur ishim të rinj dënesnim si fëmijë?
Netët na zinin
Duke i fshirë lotët e erës
E cila qante tok me ne.

Më duket se,
Kjo dënesje ishte vaji i jonë
Mbi gjethet e njoma të stinëve.
Kur e përkundnim mbrëmjen
I numëronim ,
Puthjet e yjeve endacak.

Kjo ishte e vetmja mënyrë
E dashurisë platonike,
Edhe pa e prekur njëri - tjetrin
Në shpirtin e barit,
Ekzaltoheshin gishtat dhe thonjtë
Sa që buzët tona,
I përngjanim puthjeve të para.

Në kontrapunktin e kujtesës
Cikli i tretë

NGA ZËRI I TOKËS MËMË

Në zgërbonjën e shpirt
Po frynë një erë e acartë,
Lisat ecin ledheve
Kjo plagë e thellë kullon pjalm.

Degët e zverdhura si gjethet
Paskan hyrë në gjumin e baladave;
Nga zëri i tokës mëmë
Si ofshamat depërtojnë kalorësit.

Me vesën e mëngjesit të përgjakur
Krojet po i lajnë sytë e përgjumura;
Dielli paska ikur nga qyteti im
Trishtueshëm cijatin shpirtrat e netëve.

Prishtinë, 21 shtator 2013

NË KONTRAPUNKTET E KUJTESËS

Kur marinarët e dehur
I ankorojnë,
Shpirtrat e dallgëve në horizont.
Atë çast,
Fillojnë tregimet fantazmagorike
Që u përngjajnë,
Përrallave të ngarkuara me iluzione.

Secili prej tyre
Ka parë nga një peshk
Të artë.
Duke ikur nga një baladë
Ose një peshk tjetër prej uji,
Që me madhësinë e tij
Ua tejkalon anijeve kozmike.

Dikur më vonë
Kur zbret muzgu katran,
Peshkatarët fillojnë të dehen
Dhe secili prej tyre u përngjan
Xhamave të kristaltë të erës,
Që bëhen copë e grim nga dhembja.

2.

Kurse loti i gotës së dehur,
Dhe i verës së trishtuar
Mbytet në dhembjet njerëzore!
Mbyten edhe disa lloje
Të peshqve jashtëtokësor,
Që asnjëherë
S'janë dukur në ujërat tona.

Pak më vonë...
Dikur kur kah mesi i natës,
Filluan të zbehen serenatat
Në kontrapunktet e kujtesës
Së detarëve...
Zënë vend të trishtuar
Ëndrrat e dallgëve të virgjëra.

EDHE QENI I SAJ

Ulur mbi një kërcu
Shkapërthen komçat e një lisi!
Gjethet e dehidruar qajnë si mushkonjat
Në zgërbonjën e rrapit plak ,
Po fshihen vitet e humbura.

Gjelbërimi sot paska mbetur i vetmuar
Askurrkund ,
S'duken kokrrat e klorofilit.
Në këtë shtëpi me xhama të thyera
Troket një vjeshtë e vonë.

Plakat e lagjes sonë
Nuk i hapin portat e as dritaret
Edhe qentë;
Paska një lehje të pakontrolluar
Kurse dyert e drunjta ,
Janë të mbyllura nga brenda.

Asnjeri më nuk hynë
E as nuk del nga ajo shtëpi,
S'dëgjohen më as të trokiturat e erës
Si zogjtë e egër.
U larguan edhe banorët e fundit
Mbase Askush më nuk troket,
Në portat e mbyllura të vjeshtës.

SËRISH VJEN PRANVERA

Nëpër portat e rrugicave të qyteti
Mbrëmë trokiti vjeshta e hershme.
Trokiti edhe era,
Me një pallto të veshur prej bredhi
Parakaloi si perëndi
Dita e parë e stinës.

Një mallëngjim i paparë
Deri më sot;
Trokiti në shpirtin tim
Më erdhi ndërmend im atë
Ai burrë sykaltër e shtatlartë.

Më dolën parasysh imazhet
Kur e lubrifikonte me një dashuri,
Të paparë deri më sot
Pushkën e vjetër,
Që shpeshherë lahej me mburrje.

Më kujtohen fjalët e babait
Kur thoshte në heshtje,
Po afrohet dimri
Duhet të pushoj pak ,
Kjo pushkë e mirë
Se sërish vjen pranvera bir.

HAPEN DHE MBYLLEN ZËRAT

Një pikë shiu..!
Si pëllumbi i plagosur
Lëshohet mbi syrin e kaltër të liqenit.
Nga piskamat e bretkosave të gjelbra
Hapen rrathët magjik,
Prej një flluske uji
Fluturojnë dy zogj të bardhë.

Shiu bie mbi daullet e zërave
Ky kor i paakorduar;
I degëve të zhveshura
I ka gjetur sonte.
Fijet e një balade të vjetër
Dhe këndon
Si mjellmat e zeza.

Nuk ndalet...
As ajo melodi e trishtë!
E një porte të vetmuar
Hapen dhe mbyllen zërat;
E zogjve të verbër
Në sqepin e lënduar të rrapit plak
Mbinë një degë e pikëlluar.

TË DIELAVE KAM KOHË

Të dielave kam kohë të hyj
Mes vargjeve,
Nga zëri i kambanës të huazoj
Tingullin e ujit,
Dhe pastaj të eci deri te portat
E të panjohurës.

Në kontrapunktin e mendimeve
T'i shaloj kuajt e egër të erës,
Kam mundësi të bisedoj
Me shirat e pasdites,
Dhe të bredhë
Nëpër kujtesën e një cope mjegulle.

Nga vetmia mësova mjeshtrin
E fluturimit të bletës,
E cila mëngjeseve me vesë
Mbjellë shpirtin e saj;
Nëpër lulet e posa të çelura
Duke e mësuar mënyrën
E frymëmarrjes së ekzistencës.

Të dielave kam kohë
Të shikoj kah bie shiu imcak
I pranverës.
Dhe kur nuk bie me rrebesh
Shiu i vjeshtës,
Pastaj bisedoj me kërpudhat
E mykura.
Dhe nga ëndrra e gjelbërimit mësoj
Për rrugët e të reshurave;
Kur kthehen përfundimisht
Në burimet e tyre paraprake .

Prishtinë, 20 shtator 2013

ATDHEU IM

Atdheu im është toka
Ku prehen gjyshërit e mi kryeneç;
Janë varret dhe tumat ilire
Që dëshmojnë ekzistencën
E fluturimit të zogjve.

Atdheu im është deti
Nga i cili dalin shpirtrat nënujore;
Dhe i këndojnë jetës
Psalmet e një kohe të lashtë
Kur shpendët e shenjtë
Fluturojnë mbi sinorët e kafshuar.

Atdheu im janë malet
Lisat e gjatë,
Me nga një zgërbonjë në shtat
Ku flenë tregimet e gjyshërve legjendar
Dhe stivohen ,
Ëndrrat e një populli të lashtë mitik.

QESHI DHE IKU

Të kujtohet mikja e ime
Fare mire të kujtohet,
Kur trokita në shpirtin tënd
Ishte një dimër i zi,
Dimri në të cilin zihej peshkvja
Në syrin e çdo shqiptari.

Çakajtë nuhasnin fërkemet e hapave
Kur kalonim rrugëve të Prizrenit,
Fshehur nën palltot shkumësa
Dhe ditarin e klasës së parë.
Kurse ti e mbaje ditarin
E klasës së tretë,
Të mbështjellë me një gazetë të vjetër.

Ka pas edhe polic të mirë
Kur na kontrolloi ai hundë madhi
Në xhepin e këmishës tënde blu.
I gjeti dy shkumësa
Dy shkumësa si dy plumba;
Të kujtohet!?
Se si i qeshi fytyra e atij burri
Aha, ju qenkeni mësuese
Qeshi dhe iku...

KJO KOHË

Kjo puhi e lehtë tinëzisht ka hyrë
Në xhepat e mbrëmjes,
Çapkënçe qeshin hijet
Me mollët e pjekura në degë.

Ti ecën si zana malit
Bulevardit tatëpjetë,
Si lumenjtë e çmendur
Pas teje derdhen shikimet.

Ofshamat s'pushojnë
Nën hapat e tua me taka,
Gjëmon shpirti i tokës
Çohen peshë kalorësit e mëngjeseve .

Prishtinë, 23 shtator 2013

KJO NATË E GJATË

Kjo natë e gjatë
Nuk paska të sosur sonte;
Ikonat si shkëlqimet e yjeve
Zbritën nga degët e mjegullave,
Dhe rrinë ulur
Te zambakët e posa paçelur.

Një freski e vonshme vjeshte
Hyri si fryma e mirë
Mes njerëzve.
Në degët e ullirit mijëvjeçar
Po ringjallet mëngjesi.

Një zog doli nga lëvozhga e drurit,
Dhe kurrë më
Nuk u ndalën fluturimet.

DERI TE ËNDRRA E JOTE

Nëse nuk beson
Si mund të mbërrish deri te ëndrra e jote!
Nuk ke asnjë shans
Miku im,
Asnjë shans
Të ecësh vertikales së gjetheve.

Kjo muranë e gërryer
Që ka mbetur në këmbë,
Vetëm në bazë të besimit
Akoma qëndron krenar si rrapi
Kundrejt horizontales.

Ne ecëm dhe mbërrimë
Këtu ku jemi,
Vetëm se vetëm që ishim të bindur
Se gjethet në shpirtrat tona,
Mund të marrin frymë
Nga rrënjët e lisit.

Edhe ti miku im
duhet të kesh besim,
Në besimin tënd
Po që se mendon ndryshe
Ti kurrë nuk mund të mbërrish
Deri te ëndrra e jote.

TE KEPI I MALLKIMIT

Po bredhin,
Po venë si kolonë lejlekësh
Nëpër ishuj të panjohur.
Shpirtrat e shirave
Këto re të dendura
Largohen si kopetë e bardha.

Në pasqyrën e qiellit gri
Tufa çafkash,
Lahen në djersët e yjeve.

Një shtëllungë tymi të zi
Si anijet e humbura,
Noton qiellit katran.

Meteorët pa shpresë
Po i ankorojnë duart e prera të erës;
Tërbimet e dallgëve
I tejkalon mundësit njerëzore.
Te moli presin nuset
Peshkatarët e zhdukur të mëngjeseve.

Po frynë
Me tërbim dallgësh çmendet deti;
Një varkë e vetmuar
Tundet diku në largësi,
Tunden dëshirat e kota të algave
Te kepi i mallkimit
Qajnë sirenat e detit Adriatik.

NJË BRESHKË E MOSHUAR

Thanë se po digjen
Trungjet e kumbullave
Një duhmë e rënd hiri.
Përhapet tekandej brigjeve të lumit
Uji i përflakur,
Si peshkvja vlon në shuplakat e ajrit.

Te një degë e thyer rri ulur
Një kumri gjysmë e pjekur,
Dhe qan si njeri
Fishkja e barit të verdhë ka kohë ,
Që po i përngjan
Ëndrrave të një pëllumbi rebel.

Sa shumë po ndryshojnë
këto imazhe morbide,
Orë e çast largohen zogjtë.

Nuk ka më degë
Në fushat e kumbullave,
Një breshkë e moshuar
Ecën pa një këmbë.

Një zjarr i tërbuar
Seç e djegë fushën e pikëllimit!..
Në buzët e shkrumbuara të sinorëve
Si rrëshira e verdhë,
Po kallen flakë ëndrrat e lastarëve.

DY HIJE TË PANJOHURA

Ndonjëherë lëvizim ngadalë
Shikimet tona të plogështa,
Përvidhen përreth petaleve të zeza
Të zambakëve.

Kori i bretkosave në frymëmarrjen e erës
E kërkon shkopin e dirigjentit;
Psalmet kanë mbetur si fëmijët bonjak
Jashtë xhamave të kujtesës,
Një arkivol i zi proteston te varret.

Dy hije të panjohura,
Filluan të ngjizen te murishtat.
Mes gishtave të verdha
Të guralecëve gri,
Shumohen algat e murrme të vjeshtës.

Na mbyti kjo stinë e pashpirt
Lumenjtë e gjakut çmendurisht;
Depërtojnë nëpër lëkurën e tokës
Dikush me qëllim ose pa të
I kyçi llambat e shkyçura,
Nga shpirti i vdekur i liqenit
Po dalin do zogj të imagjinuar.

Prishtinë, 25 shtator 2013

SHËNIME BIOGRAFIKE PËR AUTORIN

Adem Zaplluzha u lind në Prizren, më 1943. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, ndërsa Akademinë Pedagogjike në Prishtinë. Një kohë punoi si mësues nëpër fshatrat Studençan të Therandës (ish Suharekës) dhe Hoça e qytetit, afër Prizrenit. Ndërkohë punësohet si përkthyes në Korporatën Energjetike të Kosovës. Me shkrime filloi të merret kryesisht me poezi që nga mosha e fëmijërisë. Rrugën letrare e nisi me vjershën e parë për fëmijë të cilën e botoi në revistën "Pionieri", më 1957. Si i punësuar në Korporatën Energjetike të Kosovës bashkë me shokët e punës dhe pendës themeloi grupin letrar "Lulëkuqet e Kosovës". Në Kuadër të punës së këtij grupi letrar qe botuar përmbledhja "Ngjyra e kohës", në të cilën u përfshi një numër i konsideruar i poezive të tij. Krahas krijimeve të publikuara në revistat për fëmijë, botoi edhe një serë shkrimesh nëpër gazetat e kohës që dilnin në Prishtinë dhe Shkup. Është anëtar i Lidhjes së shkrimtarëve të Kosovës, prezent në disa antologji dhe në librin Kosova letrare të poeteshës Monica Mureshan. Është prezantuar në *Leksikonin e Shkrimtarëve Shqiptarë 1501-1990,* nga Hasan Hasani, në *Leksikonin Shkrimtarët Shqiptarë për fëmijë 1872 - 1995* nga Odhise K. Grillo, si dhe në

librin *Portrete Shkrimtarësh* nga Demir Behluli, Prishtinë 2002.

Në vitin 2013 Klubi i Shkrimtarëve dhe i Artistëve të Durrësit ia ndau çmimin e karrierës për kontributin në letrat shqipe. Jeton dhe krijon në Prishtinë ndërsa aktivitetin letrar e zhvillon në kuadrin e Klubit letrar "Fahri Fazliu", në Kastriot.

BOTIME TË AUTORIT

1. **“Puthje”, poezi,** “Rilindja”, Prishtinë,1974.
2. “**Ecjet e viteve të mëdha”,** poezi, “Jeta e Re”, Prishtinë 1995.
3. **“Çamarrokët e Thepores”,** poezi për fëmijë, “Shkëndija”,Prishtinë 1996.
4. **“Muret”,** poezi, “Jeta e Re”, Prishtinë, 1997.
5. **“Morfologjia e dhembjes”,** poezi, “Faik Konica”, Prishtinë,2000
6. **“Ai vjen nesër”,** poezi, Qendra e Kulturës, Klubi letrar“Fahri Fazliu”, Kastriot, 2oo7
7. **“Letër nga mërgimi”,** poezi, Klubi letrar “Fahri Fazliu”Kastriot , 2007
8. **“Letër nga mërgimi 2 “** poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar , “Fahri Fazliu”, Kastriot 2007
9. **“Udhëndarja”,** poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar ,“Fahri Fazliu”, Kastriot , 2008
1o. **“Thirrje e gjakut”,** poezi,”Qendra e Kulturës”, Klubi letrar, “Fahri Fazliu”Kastriot 2008
11. **“Asgjë sikur molla”,** poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, Kastriot, 2009.
12. **“Vesa në lotin tim”,** poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar “Fahri Fazliu”, 2009,
13. “**Puthja e gozhduar”,** poezi, “Qendra e Kulturës”, Klubi letrar, “Fahri Fazliu”, Kastriot , 2oo9.
14. **“Kashelasha në vargje”,** poezi për fëmijë,” Qendra e kulturës, Kastriot, 2oo9.

15. **“Pema e bekuar”,** E përkthyer, Rumani, 2o1o.
16. “Bajraktarët e vatanit”, poezi satirike, Klubi letrar, ”Fahri Fazliu” Kastriot , 2010.
17. **“Hijet e ndryshkura”,** poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot,2010.
18**.”Stuhi në Kutulishte”,** poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot,2010.
19. **“Posa ikte nata”,** poezi, “Qendra e kulturës “, Kastriot,2010.
2o**. “Loja e myshqeve”,** poezi,”Qendra e kulturës”, Kastriot,2010.
21. **”Lumëbardhi dhe gjëma”,** poezi,”Qendra e kulturës”,Kastriot, 2o1o
22**. “Metafora e heshtjes”,** poezi, “Qendra e kulturës”,Kastriot, 2o1o
23. **”Hyji në Prekaz”,** poezi,”Qendra e Kulturës”, Kastriot,2010.
24. **”Sinorët e hinores”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot 2010
25. **”Don Kishoti dhe Rosinanti”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot, 2010
26**.”Zjarri i dashurisë”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2010
27. **”Kur likenet vallëzojnë”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot, 2010
28**. “Ditari në vargje”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 201O
29. **“Tingujt që nuk përfundojnë”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve –Kastriot, 2o1o.
3o**. “Shtegu i mallit”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot, 2010

31**. ”Korniza e thyer”’**,Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, -Kastriot, 2010
32. **“Zgjimi i gjëmës”,**Poezi, Shoqata e Shkrimtareve-Kastriot, 2010
33. **“Vallja mistike”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2010
34. **”Merre kodin”,** Poezi për fëmijë, Shoqata e shkrimtarëve Kastriot,2011
35. **“ Letër atdheut”** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2011
36. **“ Tejdukshmëria e shiut”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o11
37. **“ Përtej teje”**,poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2011
38. **“Sa afër e sa larg”** , poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot, 2011
39. **“Vallja e zanoreve”,** Poezi , Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o11
40. **“Ikja e eshtrave”,** Poezi për të rritur, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o11
41**.”Kalorësit e mjegullave”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot, 2012
42. **“Hingëllimat e shiut”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot 2012
43. **“Kur pemët i ndërrojnë këmishët”.** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
44. **“Mirëmëngjes Imzot”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve – Kastriot, 2o12
45**. “Kafshimi i mikut”,** Poezi satirike, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2012
46. **“Atje tej maleve”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve , Kastriot-2012

47. **“Heshtja që del në shesh,”** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, Kastriot -2o12
48. **“Portat e shpresës”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve, Kastriot-2012
49. **“Në dhomën time gjysmë të errët”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
5o. **“Kinse Lojë Shahu”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
51. **“ Për çdo dekadë nga një baladë “,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot, 2o12
52. **“Fusha e mëllenjave”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
53. **“E kujt është kjo vetmi”,** Poezi, Shoqate e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
54. **“Mos pyet për adresën e lumit”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot, 2012
55**. “ Stoli në parkun vjetër”** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2012
56. “**Urori i stralltë”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve –Kastriot, 2o12
57**. “Po të mos ishte fjala”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve- Kastriot,2o12
58. **“Thyerja e urave”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve –Kastriot, 2o12
59**. “ Trokëllimat në gjumin e dallgëve”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
60**. “ Në flokët e dëborës”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
61**. “Një grusht nostalgji”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2o12
62. **“ Kur filluan të flasin njerëzit”,** poezi, Shoqata e shkrimtarëve- Kastriot, 2012

63. **“Kur stinët kapërcejnë fshehurazi”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot,2012
64. **“ Lisi në rrënjët e veta”** , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot 2o12
65. **“Eca ecëm dhe do ecim”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve – Kastriot, 2o12
66**. “Fëmijët e erës”,** Poezi, Shoqata e shkrimtarëve-Kastriot 2012
67. **“ Çast në fund të stinës”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot-2012
68. **“Si të flas me drurët”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2012
69**, “ Më pëlqejnë mendimet e tua”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot , 2012
70**. ”Andej dhe këndej kohës”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot , 2012
71**. “Zëri i heshtjes”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve- Kastriot, 2o12
72**. “Kush i lexoi letrat prej erës”,** poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2012
73**. “ Fluturimi i korbave në netët pa hënë”,** prozë poetike, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
74. **“Koha e ime dhe koha e jote”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot , 2012
75**.” Diku te një baladë”,** Poezi, Shoqate e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
76**. “ Sonte çdo gjë po i përngjan lotëve”**,Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve –Kastriot, 2012
77 “ Ky def prej hëne”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-Kastriot, 2012
78**.“Pyesni zogjtë në ikje ”,**Poezi , Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”- Kastriot 2013

79 **“ Fërfërimë gjethesh**”, Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot- 2013
80**. “Refrene yjesh”,** Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2013
81. **“Te delta e mjellmave”,** Poezi, Shtëpia botuese “Fahri Fazliu”, Kastriot- 2013
82.**“Rinjohja”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2013
83**.“Diku në fund të një fillimi”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2013
84**.“Makthi i hijes”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-“ Fahri Fazliu”Kastriot, 2013
85.**“Një zog prej uji”,** Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”- Kastriot
86.”Asnjë fjalë nuk frymon”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2013
87.”Daullet e një nate”, Poezi, Shoqata e shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot 2013
88.”Sytë e gurtë të erës”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”- Kastriot, 2013
89.”Kur dehen perënditë” , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot -2013
90. “Fjetëm njëqind shekuj” Prozë poetike, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot , 2013
91.”Krakëllimat e natës”,Poezi, Shoqata e shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot, 2013
92. “Ndjekësit e enigmave”, Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve “Fahri Fazliu”-Kastriot -2013

93. "Atdheu i paçmuar" Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve-" Fahri Fazliu"- Kastriot, 2013
94."Psalm i harruar ", Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve, "Fahri Fazliu"Kastriot 2013
95,"Për kë po bie moj kambanë", Poezi Shoqata e Shkrimtarëve "Fahri Fazliu"-Kastriot, 2013
96. "Mbi flokët e ullukëve", Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve "Fahri Fazliu" Kastriot 2013
97. "Menatë vijnë lejlekë", Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve "Fahri Fazliu" Kastriot 2013
98. "Loti i gotës së derdhur" , Poezi, Shoqata e Shkrimtarëve "Fahri Fazliu" Kastriot 2013

PËRMBAJTJA

Si një imazh i largët - Cikli i parë 11
Eja sonte! 13
Kur dënesin pemët 15
Akoma nuk kuptuam. 16
Ky gjeth që bie në tokë 18
Ajo ishte dielli 19
Kryqi im prej lotëve 21
Më prit moj vogëlushe 22
Pikonte trishtimi 23
Shko ku të duash 24
Jam po ai njeri 25
Sot më nuk jam unë 27
Degët e thyera të pemëve 28
Kalon dete e male 30
Nëpër këto rrugë të pasosura 31
Ia falën edhe dashurinë 32
Të mbijë edhe e nesërmja 33
Cili plep 34
Padukshmëria 36
Si një imazh i largët 38
Kam nevojë 39
Vetëm një qyqe mali 41
Një ditë do të kthehem! 42
Kur e përkundnim mbrëmjen - Cikli i dytë 43
Njerëzit dhe rrugët 45
Po të kisha mundur 47
Bini daullexhi.!? 48
Secili prej nesh 50
Një zog 51
Në një rrugë asnjanëse 52

Do presim edhe një kohë 53
Trokit si i çmendur 54
Sa e gjatë kjo natë 55
Miku im i mirë 57
Pamë një akt të ngrirë! 58
Mëngjesi gdhiu 59
Zarfi i kaltër 60
Era e ftohtë 61
Presin vdekjen e dikujt!? 63
Shkunde trishtimin 64
Sa herë që e hapëm gojën 65
Miqtë e mi të vjetër 66
Pak është vonë 68
Thua se janë të drunjta 70
Ku po të lëmë kështu 71
Kur e përkundnim mbrëmjen?! 73
Në kontrapunktin e kujtesës - Cikli i tretë 75
Nga zëri i tokës mëmë 77
Në kontrapunktin e kujtesës 79
2. 80
Edhe qeni i saj 81
Sërish vjen pranvera 82
Hapen edhe mbyllen zërat 83
Të dielave kam kohë 84
Atdheu im! 86
Qeshi dhe iku 87
Kjo kohë 88
Kjo natë e gjatë 89
Deri te ëndrra e jote 90
Te kepi i mallkimit 91
Një breshkë e moshuar 93
Dy hije të panjohura 95

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

821.18-1

Zaplluzha, Adem
Loti i gotës së dehur / Adem Zaplluzha. - Kastriot : Shtëpia Botuese “ Fahri Fazliu”, 2014. - 108 f. ; 21 cm.

Shënime biografike për autorin : f. 97-105

ISBN 978-9951-664-14-1